



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13 Shtator 2022

Nr: 194

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË MALLAKASTËR, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË, ZJ. ENKELEDA RESMI HYSKAJ**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 3378 prot., datë 24.06.2022, këshilli i bashkisë Mallakastër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Mbarime Jonus Isufaj, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Mallakastër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 17, zj. Enkeleda Resmi Hyskaj

Me shkresën nr. 2856, prot., datë 04.07.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Mallakastër, zj. Enkeleda Resmi Hyskaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.



Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 37 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Enkeleda Resmi Hyskaj, rezulton se: Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga “Barjamaj” në “Hyskaj”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 2933 prot., datë 19.07.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2934 prot., datë 19.07.2022 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Enkeleda Resmi Hyskaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 7652/1 prot., datë 08.08.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Enkeleda Resmi Hyskaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër, e cila rezulton se nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 8734/1 prot., datë 02.08.2022, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Enkeleda Resmi Hyskaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Enkeleda Resmi Hyskaj, në këshillin e bashkisë Mallakastër nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Mallakastër, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Enkeleda Resmi Hyskaj.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

